

# Akt Themelimi

I Shoqërisë Tregtare

“ Serotonin Gym Sh.P.K ”

Tiranë 24.11.2023

Sot, më datë 24.11.2023, u mbledh asambleja e shoqërisë Serotonin Gymt Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e të drejtës Shqiptare, me adresë kryesore Rruga Komuna e Parisit, Tirane, Shqiperi, me pjesmarrës ;

- Imela Mala shtetase shqipëtare, lindur më 02.11.2003, në Shkodër dhe banues në Rruga Hasim Vokshi, Tirane, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr. K36102063M, zotërues i 50% të kapitalit të shoqërisë.
- Jena Mala shtetase shqipëtare, lindur më 21.11.2000 në Shkodër dhe banues në Rruga Hasim Vokshi, Tirane, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr. K06121078N, zotërues i 50% të kapitalit të shoqërisë.

Të cilët kanë vendosur themelimin e shoqërisë Serotonin Gym, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtëme ;

## Neni 1

Shoqëria Tregtare Serotonin Gym, është krijuar sipas ligjit 9901 i datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shqëria).


Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Shoqëria ka selinë e saj në Rruga Robert Shvarc, kompleksi Niku Construction, shk.5, kati 0, Komuna e Parisit, Njesia Administrative nr.5, Tirane, Shqiperi. dhe do të mund të vendosë nese do ketë seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjensi në Shqipëri dhe jashtë shtetit.

## Neni 2

### Emri i Shoqërisë

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin Serotonin Gym.



## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në vlerën 50,000 Leke dhe është i përbërë nga një kuotë.

Themeluesi merr në pronësi kuotën e tij në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin.

## Neni 6

### Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

## Neni 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar Ligjit nr.9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë;

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
2. Administratori

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga administratori i vetëm i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtëritshëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë do të jetë Imela Mala shtetas e lindur më 02.11.2003 në Shkodër dhe banues në Rruga Hasim Vokshi, Tirane, moshë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit nr K36102063M.



## Neni 12

### Dispozitat përfundimtare

Ky Akt Themelimi u hartua në katër kopje në gjuhën Shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, të cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

### Ortakët

**Imela Mala**



Imela Mala.

**Jena Mala**



Mala

